



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:042466
Datë: 30.01.2024
Numri i dokumentit: 05258479

C.nr.280/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: H. B. nga fshati K. i M. – M.. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Sheremet Ademi dhe Leutrim Ademi me seli ne Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestuese kompensimi për shpenzimet e udhëtimit, jashtë seancës gjyqësore konform nenit 398 të LPK-së, me datë 30.01.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H. B. nga fshati K. i M. – M., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës -Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, që paditësit, në emër të kompensimit për udhëtim për periudhën kohore 04.03.2019-22.11.2022 apo për 550 dite t'ia paguaj shumen prej 385.00€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 02.03.2022, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. APROVOHET PJESERISHT si bazuar kërkesa e paditësit lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që **DETYROHET** e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia kompensoj paditësit shumën në lartësi prej 78.00 euro, ne emër te përpilimit te padisë si dhe shumen prej 21€ ne emër te taksës gjyqësore, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET PJESËRISHT si e pa bazuar përtej pjesës së aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kërkesa e paditësit lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, me të cilën kanë kërkuar në emër të përpilimit te padisë 26.00€ dhe për seance gjyqësore ne vlere prej dhe 135.00€.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datë 02.03.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve për udhëtim gjate ditëve te punës.

Në padi ka theksuar se paditësit nuk i'u është bërë kompensimi i shtesave për udhëtim edhe pse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë. I njëjti përmes te autorizuarit te tij me datën 20.11.2023 ka prezicuar kërkesëpadinë dhe ka deklaruar se bazuar ne vërtetimin e lëshuar nga Agjencioni Turistik "U.", me te cilin vërtetohet se ka udhëtuar nga fshati K. i M. për ne M. dhe anasjelltas, ku edhe e ka vendin e punës, sipas kontratës se punës, ashtu qe ka paguar 1€ ditore, për udhëtim, bazuar ne dispozitat e kontratës kolektive, ku përcaktohet kompensimi prej 70% te shpenzimeve te rrugës, ku ka kërkuar për 550 dite x1€/ditore, ne shume prej 550 € dhe atë 70% te shumës se përgjithshme, ne lartësi prej 385.00€, me kamatë ligjore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 104.00 € ne emër te padisë dhe 21 euro ne emër te taksës gjyqësore. Dhe 135.00€, për seancë.

E paditura në përgjigjen në padi ka kërkuar qe te refuzohet kërkesëpadie e paditëses sepse kërkesën e saj nuk e ka bazuar ne asnjë prove, me te cilën do te vërtetonte shpenzimet e krijuara siç janë p.sh. biletat e udhëtimit, për ditët për te cilat kërkon kompensimin. Paditësja nuk ka bashkangjitur asnjë bilete te udhëtimit dhe vetëm një vërtetim te një kompanie private e cila me gjase mirret me transport udhëtarësh. Njëkohësisht e paditura ka kërkuar qe te refuzohet kërkesa e paditëses lidhur me shpenzimet e angazhimit te avokatit duke kërkuar shpenzimet procedurale për përpilimin e përgjigjes ne padi ne vlere prej 78€.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8, 398 dhe 399 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi, nga provat e bashkangjitura padisë dhe atë nga: Vërtetimi me numër protokolli 165/23, i datës 15.11.2023, u provua se i njëjti është ne marrëdhënie pune ne SHML Gjinnazi "Frang Bardhi" ne Mitrovice, si mësimdhënës i gjuhës gjermane, gjykata përmes vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë për paditësen gjeti si vijon: paditësi nga data 04.03.2019 e deri me datën 22.11.2022 ka qenë prezent ne pune gjithsej për 550 dite, fakt ky qe vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHML Gjinnazi "Frang Bardhi" ne Mitrovice, me nr. te prot. 165/23, i datës 15.11.2023.

Nga vërtetimi i dt.14.11.2023, vërtetohet fakti se paditësi ka udhëtuar me Agjencionin Turistik "U." ne relacionet K. i M. – M. dhe anasjelltas, ka 550 dite pune.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Së këndejmi,

provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me ditët e prezencës në punë, gjykata i'u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Në padi është ngritur pretendimi se paditësi nuk ka pranuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në mbështetje të nenin 35 par 10 të KKAK, Nga interpretimi i kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e njëjta dispozitë është detyruese për të paditurën andaj edhe e ka detyruar të njëjtën që ti paguaj pagesën e udhëtimit për periudhën kohore të cekur në dispozitiv .

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtoreshave të arsimit në kompensim në emër të ushqimit (shujtës ditore), kompensimi i shtesave në udhëtim , si dhe gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, me datën 21.04.2021 e cila i'u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pjesërisht aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për ushqime gjatë punës dhe kompensimi e udhëtimit e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja e ka rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë te datës 02.03.2022.

Gjykata në mbështetje të nenit 452 të LPK-së vendosi si në dispozitivin e pike II të këtij aktgjykimi, ashtu që detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 99.00€- sipas tarifës së OAK.

Gjykata vendosi t'ia refuzoj shpenzimet e procedurës paditësit në vlerë 26.00 € për përpilimin e padisë ngase me tarifën e OAK, nuk parashihet vlera 104.00 € për përpilimin e padisë në vlerë

te vogël. Për seance gjyqësore gjykata e refuzoj një kërkesë te tille ngase nuk është mbajtur një seance e tille.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 8,398, 399 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROIVCË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.280/2022, datë 30.01.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.